

Albanian University

NUIS J82025002B

Tiranë, më 2 Shkurt 2021

Vende Vakante Viti akademik 2020-2021, semestri i dytë

Albanian University për vitin akademik 2020 - 2021, semestri i dytë paraqet si më poshtë vendet vakante për plotësim të personelit akademik dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike 9 vende vakante

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët, bazuar në përcaktimet e bëra në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, "Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015" dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, janë si më poshtë:

- Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në profilin përkatës, sipas lëndës që do të mbulojnë me mesatare mbi 8 (tetë);
- Preferohet eksperiencë në mësimdhënie dhe eksperiencë profesionale, e lidhur me lëndën që do të mbulojnë;
- Preferohet që aplikantët të kenë gradën shkencore "Doktor";
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme personale për vendin e punës, si aftësi komunikimi etj.

A. Departamenti i Inxhinierive: 3 vende vakante

- I. 2 vende pune për personel akademik me kohë të plotë (profesorë/lektorë) në fushën e Inxhinierisë Elektronike, Teknologjisë së Informacioni, Inxhinierisë Kompjuterike/Informatike ose ekuivalente.

Kandidatët për këto vende pune duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbrojtur doktoraturën në fushën e Inxhinierisë Elektronike, Teknologjisë së Informacioni, Inxhinierisë Kompjuterike/Informatike ose ekuivalente.
2. Të kenë notë mesatare të ponderuar mbi 8 (tetë).
3. Të kenë minimumi 3 vjet eksperiencë pune.
4. Të kenë njohuri të mira në një gjuhë të Komunitetit Europian. Gjuha angleze përbën avantazh.
5. Të kenë njohuri të mira në lëndët:
 - Hyrje në përpunim imazhi,

- Bazat e inteligjencës artificiale,
- Teknologjia Cloud,
- Hyrje në sistemet e informacionit dhe siguria,
- Hyrje në programimin e shpërndarë,
- Hyrje në programimin paralel,
- Programim në ambiente të shpërndarë 2.

II. 1 vend pune për personel akademik me kohë të plotë (profesorë/lektorë) në fushën e Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë Mekatronike ose ekuivalente.

Kandidatët për këto vende pune duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbrojtur doktoraturën në fushën e Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë Mekatronike ose ekuivalente.
2. Të kenë notë mesatare të ponderuar mbi 8 (tetë).
3. Të kenë minimumi 3 vjet eksperiencë pune.
4. Të kenë njohuri të mira në një gjuhë të Komunitetit Europian. Gjuha angleze përbën avantazh.
5. Të kenë njohuri të mira në lëndët:
 - Transmisione hidropneumatike,
 - Zbatimi dhe standardet teknologjike të sistemeve të energjisë,
 - Sistemet e menaxhimit të energjisë.

B. Departamenti Art Dizajnit: 4 vende vakante

Nevojat për staf akademik efektiv në Programin e Studimit Bachelor në "Dizajn":

- 1 **Pikturë monumentale** - një pedagog me të paktën gradën Doktor Shkencash;
- 2 **Vizatim Bashkëkohor** - një pedagog me të paktën gradën Doktor Shkencash;
- 3 **Art 2D/1(InDesign, CorelDRAW)** - një pedagog me të paktën gradën Doktor Shkencash;
- 4 **Art 3D** - Një pedagog me të paktën gradën Doktor Shkencash;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbrojtur doktoraturën në fushat: Arte/Dizajn/Arkitekturë;
2. Të kenë notë mesatare të ponderuar mbi 8 (tetë);
3. Të kenë minimumi 3 vjet eksperiencë në mësimdhënie;
4. Të kenë njohuri të mira në një gjuhë të Komunitetit Europian. Gjuha angleze përbën avantazh.
5. Të kenë njohuri të mira në lëndët për të cilat aplikon.

C. Departamenti i Shkencave Ekonomike: 2 vende vakante

- I. 1 (një) personel akademik me kohë të plotë (Profesorë/Lektorë) për grupin mësimor të "Manaxhimit".
- II. 1 (një) personel akademik me kohë të plotë (Profesorë/Lektorë) për grupin mësimor të "Ekonomiksit".

Kandidatët për këto vende pune duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbrojtur Doktoratën në fushat e Manaxhimit ose Ekonomiksit dhe/ose ekspertizë të spikatur në fushat përkatëse;
2. Të kenë notë mesatare të ponderuar mbi 8 (tetë) të studimeve Master, nëse nuk ka Doktoraturë;
3. Të kenë minimumi 3 vjet eksperiencë pune dhe eksperiencë në mësimdhënie;
4. Të kenë njohuri të mira profesionale të gjuhës angleze.
5. Të kenë njohuri të mira në lëndët që duan të angazhohen.

➤ Të interesuarit mund të aplikojnë me një CV dhe letër interesi në adresën elektronike e-mail: burimenjerezore@albanianuniversity.edu.al.

➤ Aplikimet janë të hapura deri më 1 Mars 2021.

